



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11/09/2020 Ref.: 1573/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

#### V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit ESLG për periudhën tre vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2023:
  - Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës, MA, 120 ECTS, maksimum 80 student për vit akademik
  
- II. Refuzohet akreditimi i programit të studimit i Kolegjit ESLG:
  - Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës, BA, 180 ECTS
  
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Kolegji ESLG ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programe të studimit të cekur në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin ESLG, me qëllim të vlerësimit programin e studimit.

Sa i përket programit të studimit të cekur në dispozitivin I, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se ky program i përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e akreditimit.

Sa i përket programit të studimit të cekur në dispozitivin II të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se ky program përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht nuk ka rekomanduar akreditimin e tij. Për programin e studimit Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës, BA 180 ECTS, në kapitullin që lidhet me misionin, objektivat dhe administrimin, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se strategjia e tri viteve të fundit nuk ka funksionuar dhe kjo ka rezultuar në një rënie të madhe të numrit të studentëve. Bashkëpunimi në mes të institucionit Nova Gorica dhe ESLG është i paqartë dhe jo transparent. Një tjetër dobësi është konsideruar edhe rezultatet e të nxëniet të cilat duhet të ndërlidhen më mirë në aspektin e shkencës dhe industrisë.

Sa i përket Menaxhimit të Cilësisë ekspertët theksojnë se është e çuditshme se si kolegji nuk ka arritur të identifikoj arsyen e rënies drastike të numrit të studentëve. Ndonëse ekspertet përmendin faktin se ka disa procedura të cilat ndihmojnë në grumbullimin e të dhënave, ato nuk janë inkorporuar siç duhet në raportin e vetëvlerësimit, dhe nuk ekziston një plan konkret vjetor mbi të cilin ato do të duhej të përmirësoheshin. Gjithashtu është vënë re se ndonëse studentët janë pjesë e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, ata nuk janë marrë parasysh gjatë hartimit dhe dizajnit të kurrikulës.

Sa i përket infrastrukturës dhe burimeve, gjatë takimeve me student është kuptuar se të gjitha ligjërata mbahen vetëm pas orës 16:00. Nuk ka një plan të qartë i cili siguron qëndrueshmëri financiare. Gjithashtu institucioni nuk ka siguruar infrastrukturë për studentët me nevoja të veçanta.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji ESLG
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



*G. Luboteni*  
\_\_\_\_\_  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë